



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

05 NR 790

Datë 21.08.2022

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar Nr.04/L-032, Ligjin për Arsimin profesional 04/L-138 në Republikën e Kosovës si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria komunale e Arsimit shpall

**KONKURS PLOTËSUES**  
**PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023**

**1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt**

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2022/23, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

**2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim**

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

**Fletëparaqitjen** (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)  
**Dëftesën** origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe  
**Ekstraktin e lindjes.**

**3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve**

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2022/2023, bëhet më datën 22, 23 dhe 24 gusht, 2022 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 25.08.2022.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 27.08.2022.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

**A. Kriteret për regjistrim**

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- |                                          |       |         |
|------------------------------------------|-------|---------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar      | (40%) | 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare në test | (20%) | 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi              | (40%) | 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

**Gjimnazi " Jeta e re"- Suharekë**

Nr	Shkenca natyrore	Shkenca shoqërore	Vende te lira
<b>1</b>	12	75	87
	<b>Gjithsejt</b>		<b>120 nxënës</b>

**Shkolla teknike" Skënder Luarasi"-Suharekë**

<b>IAAP " Skender Luarasi "</b>						
<b>Drejtimit, Profilet dhe Numri i nxënësve</b>				<b>18.08.2022</b>		
<b>NR</b>	<b>DREJTIMI</b>	<b>Profili arsimor</b>	<b>Nr i klasave</b>	<b>Nr i nx. të kërkuar</b>	<b>Nr i nx që jane pranuar</b>	<b>Vendet e lira</b>
1	<b>DREJTIMI</b>	Media interaktive	1	24	11	13
2		Instalues elektrik	1	24	17	7
3	<b>NDËRTIMI ARI</b>	Arkitekturë	1	24	18	6
4		Teknik i izolimit të ndërtesave	1	24	5	19
6		Metalpunues dhe saldator	1	24	11	13
7	<b>TEKSTIL</b>	Rrobaqepësi	1	24	16	8
8	<b>ARTI</b>	Dizajn i tekstilit dhe i veshjeve	1	24	20	4
<b>GJITHSEJ</b>			<b>11</b>	<b>264</b>	<b>201</b>	<b>70</b>



**Shkolla profesionale " Abdyl Ramaj"-Shirokë**

KOMUNA	SHKOLLA	LËMI ARSIMOR	PROFILI ARSIMOR	Numri paraleleve	Numri nxënësve	Vitet e shkollimit
SUHAREKE	IAAP " Abdyl Ramaj "	EKONOMI	Banka, financa dhe sigurime	1	11	2+1
			Marketing	1	12	2+1
		KIMI - TEKNOLOGJI	Teknologji e material. ndërtimore	1	12	2+1
			Teknologjia e riciklimit	1	24	2+1
		AGROKULTURA	Teknik Agrobiznesi	1	13	2+1
		TEKNOLOGJI USHQIMORE	Teknologji Ushqimore	1	8	2+1
		HOTELERI	Asistent restoranti	1	10	2+1
			<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>90</b>	

**Drejtori i Drejtorisë së Arsimit-Suharekë**  
**Remzi Bajselmani**

